



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
DREJTORIA E AUDITIMIT TË BRENDSHËM

Nr. 1304/3 prot.

Tiranë, më 21.03.2018

V E N D I M

Nr. 17, Datë 21/03/2018

PËR

**EVADIMIN E MATERIALEVE TË AUDITIMIT TË USHTRUAR
NË KONTROLLIN E LARTË TË SHTETIT MBI SISTEMET E
STRUKTURËS NË IMPLEMENTIMIN E PROJEKTIT IPA 2013,
“FORCIMI I KAPACITETEVE TË AUDITIMIT TË JASHTËM NË
SHQIPËRI”, NË KLSH**

Pasi u njoha me Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe Projektvendimin e paraqitur nga Grupi i Auditimit të Drejtorisë së Auditit të Brendshëm, shpjegimet e dhëna nga subjekti i audituar, mendimin për cilësinë e auditimit nga Drejtori i Drejtorisë së Auditit të Brendshëm, si dhe nga kontrolli i cilësisë pas procedurës së ndjekur për rishikimin për cilësinë e auditimit, mbi vlerësimin mbi objektivitetin dhe cilësinë e auditimit, vlerësoj se Kontrolli i Lartë i Shtetit i është përgjigjur në kohë nevojave të projektit për ngritjen e strukturës përgjegjëse për implementimin dhe monitorimin e programit IPA në përputhje me kërkesat e përcaktuara në Manualin e SPO të miratuar nga ZKA/ NAO Zyrtari Kombëtar Autorizuar. Nga shqyrtimi i veprimtarisë së strukturës që implementon projektin IPA në KLSH, rezulton një menaxhim i kujdesshëm i planit të projektit dakordësuar në mbledhjet e komitetit të projektit dhe dokumentit përkatës që miratohet në këtë mbledhje. Funksionon më mënyrë efektive sistemi i kontrollit të brendshëm brenda strukturës në

përputhje me detyrat funksionale të përcaktuara në përshkrimin e punës të çdo pozicioni të kësaj strukture.

Gjithsesi, konstatohet se strukturat e përfshira në menaxhimin e fondeve IPA duhet të ndjekin kërkesat e EU për komunikimin dhe vizibilitetin dhe të zbatojnë përcaktimet e bëra në Manualin e Procedurave, Manualin e Riskut, Manualin e Monitorimit dhe Vlerësimit dhe Manualin e Programimit të nxjerra nga Koordinatori Kombëtar për IPA, fusha këto ku ka nevojë për përmirësime të vogla.

Për sa më sipër dhe bazuar në nenet 10 dhe 15, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

V E N D O S A:

- I.** Të miratoj Raportin Përfundimtar të Auditimit mbi sistemet e strukturës në implementimin e projektit IPA 2013, “Forcimi i kapaciteteve të auditimit të jashtëm në Shqipëri”, në KLSH.
- II.** Të miratoj rekomandimet e përcaktuara dhe të kërkoj marrjen e masave, për sa vijon:

KONKLUZIONI I AUDITIMIT

Funksionimi i sistemi të menaxhimit dhe kontrollit për komponentin I të projektit IPA 2013 “Forcimi i kapaciteteve të Auditimit të Jashtëm”, kriteret e akreditimit si dhe funksionimi i rregullt sipas procedurave të akredituara, për periudhën 01.01.2017 - 25.12.2017 vlerësohet në Kategorinë 1: *Funksionon mirë por ka nevojë për përmirësime të vogla në fushat ku janë konstatuar gjetjet.*

A. MASAT ORGANIZATIVE

Gjetje1: Bazuar në aneksin A të Marrëveshjes Kuadër dhe sipas Manualit të Procedurave, versioni 4, strukturat e përfshira në menaxhimin e fondeve IPA duhet të ndjekin kërkesat e EU për komunikimin dhe vizibilitetin. Në këtë kuadër në strukturën e SPO-së nuk është caktuar një person përgjegjës që të mbikëqyrë respektimin e gjithë kërkesave lidhur me publicitetin si dhe të garantoj pajtueshmërinë me informacionin dhe kërkesat për

publicitetin. Kjo detyrë përmbushet periodikisht ose në rastet kur lind nevoja nga ana e strukturës IPA.

Për sa më sipër rekomandojmë:

Zyrtari i Lartë i Programit, SPO-ja, të ndërmarrë masat e nevojshme për të bërë të mundur caktimin e një anëtari të njësisë IPA, përgjegjës për publicitetin si dhe të ndjekë kërkesat dhe udhëzuesit e EU-së për komunikimin dhe vizibilitetin.

Menjëherë dhe në vijimësi

Gjetje2: Bazuar në aneksin A të Marrëveshjes Kuadër dhe sipas Manualit të Procedurave të SPO-së, versioni 4, SPO duhet të respektojë dhe të zbatojë përcaktimet e bëra në Manualin e Procedurave, Manualin e Riskut si dhe Manualin e Monitorimit dhe Vlerësimit dhe Manualin e Programimit të nxjerra nga NIPAC. Nga auditimi u konstatua se nuk është caktuar një person përgjegjës brenda strukturës së SPO-së si “Koordinator i Manualit” i cili duhet të ketë, përveç të tjerash, edhe përgjegjësinë e mbajtjes së Regjistrit të modifikimeve të manualeve me qëllim parandalimin e përdorimit të dokumenteve jo në fuqi dhe në të njëjtën kohë për të ruajtur gjurmën e auditimit.

Për sa më sipër rekomandojmë:

SPO-ja të propozojë caktimin e një anëtari në funksionin e “Koordinatorit për Manualin” duke bërë në këtë mënyrë parandalimin e problemeve që kanë të bëjnë me mungesën e manualeve apo me mundësinë e parandalimit të riskut në përdorimin e manualeve të cilat nuk janë në fuqi.

Menjëherë dhe në vijimësi

Në mbështetje të ligjit nr. 114/2015, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” dhe UMF nr. 100, datë 25.10.2016 “Për Miratimin e Manualit të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik”, për masat e marra sipas programeve të përgatitura për zbatimin e rekomandimeve, të njoftohet Drejtoria e Auditimit të Brendshëm.

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm, Zyrtari i Lartë i Programit (SPO) dhe Drejtoria e Auditimit të Brendshëm.

Bujar LESKAJ

K R Y E T A R